

Specifikacion për realizimin në skulpturë të bustit kushtuar figurës së shquar Max van der Stoel

Punimi duhet të jetë shprehje artistike realiste dhe figurative me destinacion për jetësimin e tipareve dhe personalitetin psikologjik të Max van der Stoel.

Punimi do të paraqitet në formën artistike të bocetit, i shoqëruar me maketin përkatës dhe foto të strukturës arkitektonike të mjedisit.

Busti duhet të jetë i realizuar në lartësinë 70 cm. Portreti i Max van der Stoel të jetë në madhësi natyrale, ku të dallohen qartë tiparet dhe psikologjia e tij.

Busti duhet të jetë i realizuar në materialin allçi i derdhur në bronzë cilësore dhe i vendosur në bazament, në lartësi 1 m - 1.10 m, i mbështjellë me granit dhe i gravuar me emrin e Max van der Stoel dhe të dhënat tjera (opsionale: me shkronja të ngjitura Max van der Stoel).

Artisti duhet të dorëzojë konstruksionin financiar në përmasat e kërkuara dhe një CV të plotë personale. Ky dokumentacion është i vlefshëm për punën dhe diskutimet e komisionit, si dhe për arkivimin e këtij fakti në dokumentacionin e artistit fitues.

Afati i fundit i dorëzimit të ofertës deri më datë: 30. 09. 2011. Realizimi i bustit në përmasat e përcaktuara dhe vendosja e bazamentit të tij në vendin e përcaktuar në kampusin e Universitetit duhet të bëhet në afat prej 40 (dyzet) ditëve nga shpallja e artistit fitues dhe nënshkrimi i kontratës me të njëjtin.